



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT "GJERGJI JANO"

Nr. 464 Prot

Korçë, më 03.12.2020

Nr. 353 Dosje

URDHËR

PËR HEQJEN E MASËS SË SEKUESTROS KONSERVATIVE

Drejtuar : Q.K.B

TIRANE

Unë, Gjergji Jano, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat në zbatim të Titullit të Ekzekutimit Nr.256 Akti datë 24.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, kam vënë në ekzekutim këtë Titull, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.353 Datë 06.07.2020 kërkesën e kreditorit "Albert Latka" ndaj debitorit Shoqërisë tregëtare "New Style Italian" Shpk në lidhje me titullin ekzekutiv vendimi Nr.256 Akti datë 24.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë

Pasi fillova menjëherë procesin e ekzekutimit të detyrueshëm për detyrimin që përmban Titulli i Ekzekutimit vendimi Nr.256, datë 24.02.2020 në referim të nenit 519 të K.Pr.Civile, kam kaluar në venie sekuestro konservative, pasi konstatova se nuk respektojnë afatin e këtij lajmerimi.

Urdhër për vendosjen e sekustros konservative është dërguar edhe :

Q.K.B Tiranë me shkresën Nr.209 Prot datë 06.07.2020

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet procedurale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titujve ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ:

Adresa: Lagja 3 Rr:"Sedat Babani" Zyra Nr.3 Korçë Tel- 082 500 215 e-mail:gjergjijano@gmail.com



Se më datë 03.12.2020 me Nr.441 Prot, është regjistruar kërkesa e Kreditorit "Albert Latka" i cili ka dërguar shkresën me Datë 01.12.2020, ku kërkohet pushimi i ekzekutimit të Titullit ekzekutiv Nr. 256 Akti , Datë 24.02.2020 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Në këto kushte, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 37. Pikat (b,c) të Ligjit Nr.26/2019 "Për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Privat",

URDHËROJ

1. **Heqjen e masës së Sekuestros Konservative**, të vendosur me anë të shkresës Nr.209 Prot., datë 06.07.2020 mbi të gjitha aksionet e zotëruara nga debitori :

- Shoqëria tregëtare "New Style Italian" shpk me Nr Nipt-i L81813006U, me administrator z.Roberto Casini

2. **Të njoftohem dhe informohem** menjëherë në formë shkresore në lidhje me procedurën e heqjes së masës së sekuestros konservative nga ana Juaj .

Lidhur sa më sipër, duke e konsideruar këtë urdhër të plotë dhe konform kërkesave të ligjit, Ju vë në dijeni se:

- a) Personat që bëhen pengesë për zbatimin dhe realizimin e tij, do të përgjigjen sipas dispozitave që parashikon Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
- b) Kundër detyrimit që përcakton ky urdhër, i cili është një veprim procedural përbarimor i referuar në K.Pr.Civile, palët mund të paraqesin ankim në Gjykatë, brenda 5 (pesë) ditëve.
- c) Ky urdhër mbahet në 6 (gjashtë) kopje.

Përbaruesi GJYQËSOR
Gjergji JANO

